

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E HENE 14 SHTATOR 2023

Të nderuar kolegë!

Zonja drejtuese e seancës!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2022, për zbatimin e projektit “Ekonomia Qarkulluese për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në Shqipëri”, ka si qëllim të ratifikojë një marrëdhënie asistence dhe bashkëpunimi në vazhdimësi midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale Gjermane. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje fillon brenda vitit në të cilin jemi. Në fakt, bëhet fjalë për një marrëveshje granti, e cila do të ofrohet nga qeveria gjermane për zhvillimin e instrumenteve ekonomike dhe ligjore në katër komponentë: Komponenti i parë synon harmonizimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve me Acquis të Bashkimit Europian dhe zbatimin e tij, për të mundësuar pikërisht atë që është filozofia e madhe brenda këtij ligji, ekonomia qarkulluese, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator për menaxhimin e mbetjeve dhe ekonominë qarkulluese në përputhje me legjislacionin europian. Kujtoj këtu se ligji që kemi në fuqi është tashmë një ligj i vitit 2011, i vjetëruar, i cili ka nevojë të domosdoshme t’i përshtatet një realiteti të ri dhe sidomos një mendësie të re. Komponenti i dytë synon zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve të menaxhimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe lokal. Aktorët në nivel qendror do të trajnohen për të zbatuar e monitoruar politikatat e menaxhimit të mbetjeve, për të përmirësuar harmonizimin me agjencitë e tjera kombëtare dhe raportimin tek të gjithë aktorët përkatës, për të mos pasur veprimtari të izoluar. Për më tepër, projekti do të ndihmojë gjithashtu AKUM-in në procesin e ristrukturimit në sektorin e Ujërave të Zeza. Komponenti i tretë synon zbatimin e masave të ekonomisë qarkulluese për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor.

Deri në dhjetë bashki partnere do të mbështeten në krijimin dhe përmirësimin e masave të riciklimit të kategorive apo rrymave të ndryshme të mbetjeve. Për shembull, impiantet e kompostimit që synojnë riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të gjelbra, si dhe stacionet e rikuperimit të materialeve që gjenerohen nga mbetjet, që mund të jenë të ripërdorshme apo të riciklueshme, janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Komponenti i katërt synon të ofrojë mbështetje për biznesin, për organizatat jofitimprurëse dhe kapacitetet kërkimore, për të zhvilluar produkte, shërbime dhe modele të ekonomisë qarkulluese, biznese inovative dhe të përgjegjshme në aktivitetin e tyre. Sigurisht, kjo përfshin zhvillimin e ideve të reja të start up-eve dhe bizneseve tashmë ekzistuese, por të cilat nuk e kanë pasur qasjen e gjelbër, nëse mund ta quajmë kështu. Ndërkohë, pa dyshim që kjo gjeneron edhe krijimin e vendeve të reja të punës. Nuk e kemi për herë të parë këtë program, sepse falë këtij bashkëpunimi kemi tashmë modele të vogla, por shumë domethënëse dhe të suksesshme, të cilat kanë krijuar një sinergji për t’u ndjekur, që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me menaxhimin e mbetjeve përmes riciklimit, siç janë për shembull stacionet në Himarë apo në Sarandë, ose stacionet e kompostimit të mbetjeve të gjelbra në Cërrik, Roskovec, Belsh apo rehabilitime vend depozitimesh ilegale, të trashëguara si të tilla prej dekadash, që tashmë janë me kushte sanitare e mjedisore të standardizuara, si në Gjirokastrë, Këlcyrë, Skrapar, Burrel etj. Falë projektligjit që miratojmë sot, do të vijojmë këto programe në të tjera bashki të vendit. Shqipëria sot ka përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve. Mjaft të themi se në vitin 2013 Shqipëria mbledhte vetëm 50 % të mbetjeve urbane në të gjithë territorin, ndërsa sot mbledh më shumë se 90 % të vëllimit të mbetjeve urbane, por megjithatë ende vijojmë të riciklojmë pak, rreth 15 %.

Prandaj, na duhet të ndërtojmë modelin e ekonomisë qarkulluese si kuadër ligjor, si mendësi, si procedurë administrative, por edhe si veprimtari të bashkive, sepse sot për sot kjo është e vetmja mënyrë që bota ka shpikur për të reduktuar volumin e mbetjeve përpara së të shkojnë në pikën fundore të trajtimit të tyre. Siç është prezantuar dhe më parë, një ndër prioritetet e MTM-së për vitin 2023 e në vijim, do të jetë fusha e ekonomisë qarkulluese. Tashmë ky fokus është konkretizuar me ngritjen e një drejtorie të dedikuar për Ekonominë Qarkulluese, në strukturën e re të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që nga janari i këtij viti, e madje edhe me dy sektorë, njëri prej të cilëve do të merret me çështjet e Edukimit Mjedisor dhe të atyre që quhen 3R: reduktim, ripërdorim dhe riciklim i mbetjeve, me vizionin e riciklimit, të ripërdorimit dhe të reduktimit, që ka nisur. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2020 – 2035 kanë formuluar objektiva shumë ambicioze për ekonominë qarkulluese në zhvillim. Ky menaxhim i integruar i mbetjeve dhe aspektet e ekonomisë qarkulluese, si: përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit, që përfshin biznesin privat në të njëjtën logjikë apo prokurimi i gjelbër dhe parandalimi i mbetjeve, konsiderohen nga ky dokument strategjik si prioritate. Po kështu, me të njëjtin partner të rëndësishëm, që është Republika Federale e Gjermanisë, jo vetëm me GIZ-in, që është Agjencia e Kooperimit, por edhe me bankën KfW, është miratuar tashmë një marrëveshje tjetër, me të cilën do të kemi një mbulim të të gjithë territorit me infrastrukturën e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve edhe në qarqe të tjera, si për shembull Dibra, ku mungon infrastruktura e rëndë, që ka të bëjë me pajisjen e këtij qarku me një pikë fundore të trajtimit të mbetjeve, por edhe me përmirësim e zgjerim në qarqe të tjera, ku tashmë ka një sistem, por i pamjaftueshëm, sepse të gjitha landfill-et janë me kohë të kufizuar. Këtu kam parasysh Beratin dhe Korçën, që janë pjesë e asaj marrëveshjeje.

Të nderuar kolegë, investimet nuk janë e vetmja rrugë. Ndërgjegjësimi, edukimi dhe informimi janë armët e forta që duhen përdorur nga të gjithë, nga ne si deputetë, nga shkolla, nga media, nga qeverisja vendore dhe nga biznesi. Zbatimi i një programi kombëtar të edukimit mjedisor me anë të një marrëveshjeje ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe me disa bashki, për të zbatuar në terren programe edukimi të drejtpërdrejta me shkollat, ecin paralel edhe me programe edukimi për fëmijët e sotëm dhe konsumatorët dhe përdoruesit e nesërm, edhe për ne që jemi më të vështirë për t'u edukuar, për shkak se ka të bëjë me ndryshimin e një mentaliteti të rrënjosur prej dekadash. Nga ana tjetër dua të theksoj faktin se brenda vitit, për të parën herë do të kemi një ligj të ri, që është ligji "Për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit". Tashmë është i hartuar dhe brenda pak ditësh do të paraqitet për konsultim publik. Është hartuar në përputhje me legjislacionin europian. Së shpejti do të kemi të tjera tema lidhur me të njëjtën logjikë, që ka të bëjë me ekonominë qarkulluese. Pra, nuk është thjesht një marrëveshje, por pjesë e një zinxhiri shumë më të gjatë, që ka të bëjë me një filozofi, që nëse në vende të tjera të zhvilluara janë dashur dekada, sigurisht, si për shumë aspekte të tjera, neve na duhen vetëm pak vite për t'i kapur ato arritje. Nga ana tjetër, më lejoni të theksoj dhe të sjell në vëmendje faktin se sezoni turistik që po vijon ende, na sollti një Shqipëri shumë më të pastër se një vit më parë dhe se çdo vit tjetër më parë, duke shtuar këtu edhe kontributin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në pastrimin e plazheve, ku praktikisht, në pika të caktuara është dhjetëfishuar popullsia, krahasuar me periudhat e tjera normale të vitit. Në katër bashki kemi pasur operacione të suksesshme vitin e kaluar, këtë vit i bëmë gjashtë, duke synuar të shkojmë në tetë gjatë vitit të ardhshëm. Siç e thashë më sipër, shumë vende të tjera të zhvilluara e kanë kaluar këtë me dekada, pasi për të ndryshuar mentalitetet, me apo pa vullnet, duhet kohë. Ju ftoj ta miratojmë këtë marrëveshje në formën e këtij projektligji dhe të vazhdojmë të punojmë në këtë frymë.

Faleminderit!